



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”**  
**REKTORI**

Laboratori Kërkimor Shkencor në ish- Kombinatin Metalurgjik, i Fakultetit të Shkencave të Natyrës, në kuadër të përmbushjes së detyrimit të realizimit të vlerësimit të sistemit të brendshëm, kërkon një ekspert “Inxhinier të trajnuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për Standartin ISO 17025:2017”, me kohë pune të reduktuar vetëm për gjatë një muaji.

Prania e këtij inxhinieri është e domosdoshme për shkak të realizimit të detyrimit të vlerësimit të sistemit të brendshëm një herë në vit, brenda 6-muajve pas vizitës vlerësuese të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit në përmbushje të standardit ISO 17025:2017. Eksperti do të realizojë vlerësimin e brendshëm të dokumentacionit të menaxhimit të laboratorit; regjistrat e rishikimit të menaxhimit të kërkesave të klientëve; dosje të personelit dhe plan trajnimi i tyre; zbatimin e procedurave teknike në provat fiziko mekanike dhe kimike si dhe raportet e provave dhe përpunimit të të dhënave.

Eksperti duhet: të njohë natyrën e testeve në laborator; të jetë i pavarur nga organizmi i Vlerësimit të Konformitetit (Laboratori i akredituar); të jetë i trajnuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për njohjen e standartit ISO 17025:2017.

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Statutit dhe Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, të ndryshuar si dhe nisur nga objekti i punës që do të kryejë, eksperti duhet të plotësojë kushtet dhe kriteret si më poshtë:

1. Të jetë i trajnuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për njohjen e Sistemit të Menaxhimit dhe Cilësisë sipas standardit ISO 17025:2017.
2. Të ketë mbaruar studimet në Inxhinieri, preferohet dega inxhinieri mekanike.
3. Të ketë eksperiencë pune të njëjta ose të ngjashme me profilin e kërkuar.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në rrugë postare në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” brenda 10 (dhjetë) ditëve (**14.10.2024 – 23.10.2024**) dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”**  
**REKTORI**

- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- Vërtetim nga punëdhënësi dhe leje nga punëdhënësi;
- Çertifikata, kualifikime, dëshmi, rekomandime për aftësi të kërkuara;
- Raport i gjendjes shëndetsore, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,**  
**Rruga “Ismail Zyma”,**  
**Aplikim për pozicionin e punës: *ekspert auditimi.***  
**Elbasan**